

DEMOKRACIA,



MAGJIA E VËRTETË

## NE E DUAM DEMOKRACINË

FIJONA (10), OLSA (10), ARKENA (11), GENTIJAN (10), OLTİ (11), RONA (10), AULON (10), ANISA (11),  
BLERON (10), JON (11)

**Demokracia është e ndërlidhur fuqishëm me parimet e të drejtave të njeriut dhe nuk mund të funksionojë pa garantimin e respektimin e plotë të tyre. Edhe ne, fëmijët mund të ndikojmë që vendi ynë të ketë funksionim të drejtë**

Fëmijët dhe të gjithë qytetarët e Kosovës janë shumë të lumtur që vendi i tyre ka udhëheqje demokratike. Këtë mund ta shohim në fytyrat e secilit, përfshirë këtu edhe ne. Pothuajse është e pamundur që të na kaloj ndonjë ditë në klasë, pa qeshur. E njëjta ka ndodhur edhe sot në Punëtori. E a keni ndonjë ide se si është e mundur kjo gjë? Kjo është e mundur falë demokracisë. Ne jemi të lirë të shprehemi, ne jemi të lirë të qeshim, të luajmë, etj. Thjesht, jemi të lirë të jemi vetvetja. A ka gjë më të mirë se kjo? Shtrojani këtë pyetje vetes sa herë që mendoni se ndoshta roli i juaj si qytetarë apo edhe si nxënës nuk është shumë i rëndësishëm.


Këtë na thotë edhe shoku ynë Olti: „Nëse ndonjë ditë keni shumë gjëra për të bërë brenda një kohe të caktuar dhe dëshira për të luajtur është më e madhe sesa ajo për të mësuar, atëherë, ju duhet të bëni atë që ju bën ju të ndiheni më mirë. Në këtë rast, të luani, pse jo? Mirëpo, mos harroni të bëni detyrat pas lojës. Kjo është mënyra ideale për ta jetësuar demokracinë“.

E kemi përmendur fjalën demokraci, por ende nuk iu treguam se çka nënkupton kjo fjalë. Demokracia është sistem i qeverisjes, në të cilin të gjithë qytetarët janë dhe duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Vendi ynë ka afro 2 milion banorë dhe asnjëri prej tyre nuk gëzon më shumë të drejta se tjetri. Para ligjit jemi të gjithë të barabartë dhe pa asnjë dallim, qoftë fetar, qoftë racor apo kombëtar.



**Ne kështu të lumtur ndjehemi vetëm kur bëjmë gjëra në të mirën e vendit tonë. Ajo çka bëm sot është në të mirë të të gjithë bashkëmoshtarëve tanë. Atë që mësuar ua përcollëm përmes këtij artikulli**

Nuk jemi më si në kohën kur është shfaqur demokracia. Gjatë asaj periudhe, ka pasur shumë qytetarë të cilët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë me të tjerët. Si më të dalluar ishin shtresat e pasura. Ata merrnin vendime për të gjithë qytetarët e tjerë të atij vendi. Paramendojeni ju, tash të dashur lexues, se si janë ndjerë ata qytetarë, të cilëve u janë mohuar shumë të drejta. E ne jemi shumë me fat që nuk e kemi një demokraci të fillë. Ne jemi të lumtur kur në vendin tonë prindërit e të dy gjinive i gëzojnë të drejtat e njëjta, po ashtu trajtohen të fillë. E njëjta vlen edhe për qytetarët të cilët kushtet ekonomike i kanë shumë të mira, si ata që nuk i kanë edhe shumë të mira. Demokracia nuk njih status, nuk njih gjini, as prejardhje.



Këtu kemi vizatuar disa ta drejta dhe të mira që sistemi i demokracisë na ofron. Prandaj, lumturia jonë buron nga ky sistem

# VOTA, PËRGJEGJËSI E QYTETARËVE

OLSA (10), ANESA (10), OLTİ (10), ERZA (10), LORENT (10), DEA (10), JETMİR (10), SARA (10),  
LISA (10)



## Vota jonë është e fshehtë dhe nuk duhet të imponohet

Ne jemi nxënës të klasës së V-të. Shumë shpejt do përfundojmë shkollimi fillor, ku ishim bashkë me mësuesen për pesë vjet me radhë. Me rastin e përfundimit të klasës së V-të, mësuesja jonë e dashur ka menduar të na bëjë një befasi të këndshme. Ajo erdhi një ditë në klasë me shumë entuziazëm dhe na tha: “Të dashur nxënës, dua që së bashku të realizojmë

Lidhjen e Prizrenit, sepse ky vend na lidhet pikërisht me një njësi nga lënda e historisë. Kjo ishte njëra nga mënyrat se si ne i marrim vendimet në klasën tonë. Zgjedhjet që ne i bëjmë, duhet të jenë të menduara mirë. Disa zgjedhje janë më të rëndësishme se të tjerat. Për shembull, kur e zgjedhim kryetarin e komunës sonë. Zgjedhjet për kryetar të komunës, ne i quajmë zgjedhje lokale. Ekzistojnë edhe zgjedhjet qendrore, ku qytetarët votojnë për deputetët e Kuvendit të Koso-



Përfaqësuesit tanë, zgjedhen me anë të votave



Sot kemi zgjedhur ta kemi rolin e gazetarëve


një ekskursion. Por, për këtë shëtitje, dua që ta marr mendimin tuaj. Unë kam tri alternativa dhe ju do të zgjedhni njërin prej tyre me anë të votave tuaja, ashtu siç keni votuar edhe për kryetarin e klasës. A dëshironi të shkojmë në Parkun e Blinajës, te Lidhja e Prizrenit apo në Shpellën e Gadimës?”.

Secili prej nesh votuam. Shumica e votave ishin për

vës, të cilët janë përfaqësues të shtetit. Pjesëmarrës në zgjedhjet lokale dhe ato qendrore mund të jenë të gjithë qytetarët të cilët kanë arritur moshën 18 vjeçare. Rëndësia e votave tona është shumë e madhe, sepse ato kontribuojnë në zgjedhjen e përfaqësuesve të shtetit. Prandaj, votoni edhe ju. Vetëm kështu mund të jemi pjesë e vendimmarrjes në vendin tonë.

## TË DREJTAT TONA MBROHEN ME LIGJ

ELTON (10), AMANT (10), DIOLA (10), LORESA (10), FINESA (10), RUDINA (10), JON (10), ERINA (11),  
JON G. (11), ESRA (10)



### Ne meritojmë të jetojmë në një vend ku kemi të drejta dhe ku respektohen vlerat demokratike

Nga lënda e historisë kemi mësuar se fëmijët në të kaluarën kanë qenë të diskriminuar. Ata kanë punuar për të pasurit dhe nuk kanë pasur të drejtat, të cilat sot shumica nga ne i gëzojmë. Po ashtu, edhe sot ende shohim raste kur fëmijët nuk ndihen të sigurt brenda shtetit ku ata jetojnë. Kjo sepse brenda atij vendi



ka konflikte dhe ndoshta nuk ka sistem demokratik të qeverisjes. Për t'i përshkruar këto shkelje të të drejtave të fëmijëve, shoqja jonë Lorena në grup të vogël përmendi rastin e trajtimit të fëmijëve në Siri. Ajo na tregoi për diskriminimin dhe pasigurinë që këta fëmijë e ndiejnë. Prandaj, menjëherë ne bëmë një lidhshmëri në mes të të jetuarit në një shtet demokratik dhe të jetuarit në një shtet jo demokratik. Nga kjo pamë sesa shumë lidhen të drejtat e fëmijëve me sistemin demo-

kratik. Për këtë arsye, jemi shumë të lumtur që kemi të drejtat tona dhe që jetojmë në demokraci. Këtë e themi duke u bazuar në mundësitë e shumta që na jep shteti ynë që të drejtat tona të zbatohen me përpikëri. Mundësitë e tilla na bëjnë që ne fëmijët të ndihemi të sigurt brenda shtetit tonë.

Sistemi demokratik ndër të tjerash na ka siguruar tri institucione që garantojnë se të drejtat tona mbrohen me ligje, zbatohen nga të gjithë dhe merren masa ndaj atyre që mund t'i shkelin ato. Këto institucione janë: Kuvendi, Qeveria dhe Gjykatat.

Andaj, ne jemi shumë falenderues që sot kemi: të drejtën për identitet, të drejtën për familje, të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtën për të luajtur, të drejtën për t'u arsimuar, e shumë të drejta të tjera.

Askush nuk mund të na cenojë të drejtat tona. Të drejtat i kemi të garantuara me ligj, prandaj bëhuni qytetarë të përgjegjshëm.



Të lumtur që kemi të drejta të shumta

# RREGULLAT DHE LIGJET JANË PËR NE


ANDI (10), LEDON (10), LEDION (10), DARIS (10), ALBULENA (10), HEROLIND (10), LEJLA (10),  
ARIOLA (10), SUAD (10)

**Cili është institucioni më demokratik i vendit? Ku miratohen ligjet? Lexojeni artikullin për ta kuptuar**

Yllka është nxënëse e klasës së V-të. Ajo shkon në shkollë në orën 12:45, kurse orari mësimor fillon në orën 13:00. Pra, ajo respekton orarin për të shkuar në shkollë, sepse është një vajzë shumë e përgjegjshme. Në shkollë ka edhe shumë rregulla të tjera të cilat Yllka po ashtu i respekton. Për shembull, të mos vrapoj në hapësirën e shkollës, të mos ofendoj të tjerët, të mos dëmtoj materialet shkollore, etj. Të gjitha këto rregulla janë caktuar për të mirën e nxënësve. Prandaj, kërkohet nga ne që të jemi të përgjegjshëm dhe t'i respektojmë ato. Ligjet janë rregulla të shkruara dhe duhen të zbatohen, sepse janë shumë të rëndësishme. Në shtetin tonë demokratik, miratimi ose jo miratimi i tyre bëhet në Kuvend. Kuvendi njëkohësisht njihet si institucioni më demokratik i vendit. Deputetët janë ata të cilët i miratojnë këto vendime dhe njihen edhe si përfaqësuesit e popullit. Prandaj, votat e popullit bëjnë ndryshimin e vendit, sepse me votat e tij zgjedhen deputetët.




Ejani të mësojmë për ligjet



Në demokraci ka drejtësi



„Deputetët e ardhshëm“



Në këto tri vizatime janë paraqitur disa nga elementet e demokracisë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Shkolla e Gjelbër“  
Klasa: V-1  
Vendi: Prishtinë

